

Ndikimi i Diversifikimit të të Ardhurave në Performancën Financiare të Bankave Tregtare (Rishikim Sistematik i Literaturës)

Ervi Kosta¹, Albana Jupe^{2,*}

¹ Universiteti Bujqësor i Tiranës, Shqipëria ervikosta10@gmail.com

² Universiteti Bujqësor i Tiranës, Shqipëria ajupe@ubt.edu.al

Abstrakt

Diversifikimi në sektorin bankar ka qënë temë diskutimi për dekada në literaturë. Efektet e diversifikimit në performancën, riskun, efikasitetin dhe vlerën e bankës janë shqyrtuar gjerësisht, kryesisht në tregun bankar Amerikan dhe më vonë në atë Europian. Qëllimi i këtij punimi është të rishikojë literaturën në lidhje me ndikimin e diversifikimit të të ardhurave në performancën financiare të bankave tregtare.

Procesi sistematik i rishikimit të literaturës është bazuar në studimin e kryer nga Appiah et al.,(2015). Në total, 25 artikuj të revistave shkencore janë studiuar duke aplikuar protokolleve e specifikuar të shqyrtimit të literaturës. Rezultatet nga artikujt e përzgjedhur paraqiten dhe përmblihen në tabela dhe grafikë, për të qënë më të kuptueshëm nga ana e përdoruesve.

Studimet në lidhje me ndikimin e diversifikimit të të ardhurave në performancën bankare në vendet në zhvillim është një hendek në literaturë. Duke iu referuar studimeve të marra në shqyrtim rezulton që studjuesit nuk kanë arritur në përfundim në lidhje me ndikimin e saktë të diversifikimit të të ardhurave në performancën bankare. Indeksi Herfindahl-Hirschman (HHI) dhe raporti i të ardhurave nga jo-interesi janë përfaqësuesit më të përdorur për matjen e diversifikimit të të ardhurave. Ky rishikim sistematik i literaturës është një bazë e rëndësishme për të kryer studime të mëtejshme në lidhje me diversifikimin e të ardhurave. Prandaj, rezultati i studimit do të jetë shumë i vlefshëm si për drejtuesit e bankave ashtu edhe për akademikët.

Fjalët kyçe: Diversifikimi i të Ardhurave, Performanca financiare, Bankat tregtare, Rishikimi sistematik i literaturës

JEL Codes: G21, L25, C12

Abstrakt

The diversification in the banking sector has always been a hot topic for discussion in literature. The effects of bank diversification involving the performance, risks, efficiency and value of banks, have been thoroughly scrutinized and studied, especially in the banking market of America and later on in Europe. The aim of this study is to give a re-evaluation of the literature

*Autori korrespondent

regarding the influence of income diversification in the financial performance of the banking market.

The methodical re-evaluation of the literature is based on the study conducted by Appiah et al, (2015). A study of 25 scientific articles have been conducted in total by applying the specified protocols of a literature re-evaluation. The obtained results by the selected articles have been displayed and summarized in the tables and charts of the paper in order to be more comprehensible by the reader.

The studies pertaining the influence of income diversification in the performances of banks in developing countries has driven a wedge in literature. Referring to the conducted studies, the scholars have not come to a concrete conclusion regarding the influence of income diversification in the bank's performance. The Herfindahl-Hirschman (HHI) index and the income ratio based on non-interest are good representatives of the most utilized measurements of income diversification. This methodical re-evaluation of literature is an important basis on which to conduct further studies with regard to income diversification. Thus, bank directors and scholars shall benefit therein from the results of this study.

Keywords: Income diversification, financial performance, commercial banks, methodical re-evaluation of literature

Hyrje

Bankat dhe veprimtaria e tyre përbëjnë një nga shtyllat themelore në ekonominë e një vendi sepse këto institucione ndërmjetësuese luajnë një rol kryesor në alokimin e burimeve financiare dhe udhëheqin pjesën më të madhe të transaksioneve që ndodhin në të. Zhvillimet e sistemit financiar, pjesë e të cilit është edhe sektori bankar, reflektojnë marrëdhëniet ekonomike, politike dhe sociale të një shteti. Aktivitetet tradicionale të bankave tregtare janë: grumbullimi i depozitave dhe dhënia e kredive. Të ardhurat nga interesi, të cilat konsiderohet si burimi kryesor i të ardhurave për bankat, krijohen për të kompensuar shpenzimet operationale të huadhënies (De Young et al., 2003). Gjatë viteve të fundit, industria bankare është përballur me sfida të shumta ku më kryesoret janë zbatimi i teknologjive të reja bankare (E-banking, Mobile Banking) por edhe programeve të cilat rrisin sigurinë e të dhënave të klientëve të tyre, përshtatja me ndryshimet e reja rregullative të vendosura nga Basel 3 dhe së fundmi edhe marrja e masave për zbutjen e efekteve negative të shkaktuara nga COVID-19.

Në studimin e kryer nga Uzhegova (2015), për rëndësinë e faktorëve të brendshëm në performancën financiare të bankave tregtare në ekonominë në zhvillim, rezultoni që për periudhën e marr në shqyrtim ka rënie të marzheve të interesit. Përballja me këtë situatë ka vënë në lëvizje bankat të hulumtojnë për burime alternative të gjenerimit të të ardhurave, duke shkuar drejt diversifikimit të veprimtarive tregtare dhe bankare.

Literatura akademike sugjeron diversifikimin e produkteve si mënyrë për të ulur ekspozimin e firmës ndaj risqeve të ndryshme. Duke e parë në këtë kontekst, në sektorin bankar, institucionet arrijnë në reduktimin e rolit të ndërmjetësimit dhe

kalimin në çndërmjetësim¹ duke zgjeruar në aktivitete që gjenerojnë të ardhura. Kjo strategji çon në diversifikimin e të ardhurave, i cili mund të ndihmojnë bankat për të zvogëluar riskun si dhe për të stabilizuar fitimet, me kusht që treguesit e të ardhurave mos të jenë të lidhur me njëri-tjetrin (Busch & Kick, 2009). Në literaturën empirike ekzistuese ekzistojnë mosmarrëveshje midis autorëve në lidhje me ndikimet pozitive apo negative të diversifikimit të të ardhurave në performancën e bankave.

Pyetjet kërkimore

PK1: Cilët janë përcaktuesit kryesorë të diversifikimit në sektorin bankar?

PK2: Cila është lidhja midis diversifikimit të të ardhurave dhe performancës financiare të bankave tregtare?

Metodologjia

RSL² është një strategji e rishikimit analitik që ndihmon për të vlerësuar kontributet e mëparshme për një temë të caktuar në mënyrë efektive. Kjo mënyrë e rishikimit të literaturës mund të jetë një bazë e mirë për të realizuar studime të ngjashme në shtete/industri dhe më pas duke iu referuar rezultateve të këtij punimi, të jemi të aftë të bëjmë krahasime rezultatesh por edhe të risjellim në vëmendje të studjuesve të tjerë çështje që kërkojnë studime të mëtejshme. Diversifikimi i të ardhurave në sektorin bankar është një temë, për të cilën janë kryer shumë studime por edhe diskutime që prej vitit 1950 e deri në ditët e sotme. Të gjithë studimet që janë kryer kryesisht në USA e më pas në Europë, arrijnë në përfundim që koncepti i diversifikimit të të ardhurave në sektorin bankar është një çështje që kërkon studime të vazhdueshme. Për ta realizuar këtë procedurë do të ndjekim 5 hapa të zhvillimit të rishikimit sistematik të literaturës, të cilat janë evidentuar në studimin e kryer nga Appiah et al.,(2015).

1. Përcaktimi i fushës së studimit dhe objektivave të rishikimit sistematik të literaturës.
2. Shpjegimi i strategjisë së kërkimit
3. Aplikimi i kritereve për filtrimin e artikujve
4. Procedura e vlerësimit të cilësisë
5. Analizimi dhe raportimi i të dhënave

¹ Në anglisht “*disintermediation*”

² Rishikimi sistematik i literaturës

Fusha e studimit dhe objektivat e rishikimit sistematik të literaturës

Në këtë punim do të përpiqemi të zbulojmë pikëpamje të ndyshme në lidhje me ndikimin e diversifikimit të të ardhurave duke marr parasysh faktorët e jashtëm dhe të brendshëm që mund të ndikojnë në performancën e sektorin bankar.

Objektivat e këtij rishikimi të literaturës janë:

- Huluntimi mbi ndikimin e diversifikimit në industrinë bankare të paraqitur në literaturën e mëparshme; dhe
- Gjithashtu studimi i lidhjes së diversifikimit të të ardhurave me performancën e bankave tregtare.

Strategjia e kërkimit dhe aplikimi i kritereve për filtrimit e artikujve

Për të përmbushur objektivat e këtij punimi, si motor kërkimi për marrjen e informacionit përkatës u përdor EBSCO. Është përdorur ky motor kërkimi sepse ofron akses të lirë për marrjen e informacionit përkatës. Punimet e përfshira në studim janë të gjitha të publikuara në revistat shkencore më prestigjioze në fushën e financës dhe ekonomisë. Artikujt e përzgjedhur për studimin i përkasin viteve 2000 deri në vitin 2019. Është zgjedhur kjo periudhë kohore në mënyrë që të shikohet sesi janë rezultatet në periudha të ndryshme, duke veçuar ato studime të cilat janë realizuar pas krizës financiare të vitit 2008. Për të bërë një seleksionim të artikujve janë përdorur këto elementë:

Në momentin e kërkimit në faqen elektronike të përmendura më lart është përdorur fjala kyçe si diversifikimi i të ardhurave por edhe kritere si periudha kohore dhe kategoria e informacionit (artikuj shkencor, raporte, gazeta etj). Rrezultatet e kërkimit për këtë fjalë në EBSCO ishin 3,653 artikuj shkencor. Për të arritur në një numër më të reduktuar të artikujve u përdor kërkimi i avancuar. Në këtë fazë të kërkimit u përdorën si fjalë kyçe performanca financiare dhe banka tregtare përveç fjalës diversifikimi i të ardhurave. Rezultati i kërkimit ishte 343 artikuj. Në pamundësi për ti analizuar të gjithë artikujt në këtë studim janë marr një pjesë e artikujve që janë cituar më shumë nga autorë në mbarë botën. Të gjithë artikujt që nuk kishin të bënin me diversifikimin e të ardhurave dhe performancën në sektorin bankar u përjashtuan. Gjithashtu u përjashtuan nga studimi artikujt që nuk ishin në gjuhën angleze dhe ato që për të patur akses duhet të kryeje një pagesë. Pas aplikimit të gjithë këtyre filtrave, numri i artikujve shkoi në 40. Pasi u lexuan abstraktet e artikujve u pa e arsyeshme të përdoren vetëm 25 prej tyre.

Procedura e vlerësimit të cilësisë

Vlerësimi i cilësisë së rishikimit të literaturës bazohet në dy elementë; burimi i artikullit dhe rëndësia e përmbajtjes. Artikuj e përzgjedhur për këtë punim i përkasin revista shkencore; prandaj, cilësia e tyre konsiderohet e pranueshme nga pikëpamja botuese. Tabela 1 paraqet numrin e artikujve që janë nxjerrë nga baza të ndryshme të të dhënave.

Tabelë 1. Baza e të dhënave për RSL

Baza e të dhënave	Numri
EBSCO	4
Research Gate	1
ScienceDirect	5
Z-Library Online	11
Të tjera	4

Burimi: Llogaritje të autorëve nga rishikimi i literaturës


Nga Tabela 1 shihet që shumica e artikujve i përkasin EBSCO, ScienceDirect dhe Z-Library. Për studimin e këtyre artikujve është bërë një përzgjedhje pasi janë lexuar abstraktet e artikujve të përzgjedhur, por edhe i gjithë teksti në pjesën më të madhe të punimeve, në mënyrë që të përcaktohet qartë marrëdhënia midis diversifikimit të të ardhurave dhe performancës.

Analizimi dhe raportimi i të dhënave

Të dhënat e përpunuara paraqiten në Tabelën 3, kolona 4 e Tabelës 3 tregon numrin e citimeve për punimet e për zgjedhura. Citimet përkatëse janë nxjerrë nga Google Scholar duke përdorur programin Harzing. Duke parë numrin e citimeve, artikujt që janë referuam më shumë janë De Young & Roland (2001), Stiroh (2002), Agoraki et al. (2009), Kolona 6 tregon sesi ka rezultuar ndikimi i diversifikimit të të ardhurave në performancën e bankave. Kolona e fundit e Tabelës 3 tregon gjetjet kryesore për secilin studim.

Rezultate dhe interpretime


Kjo punim synon që të jap një panoramë të problemit të kërkimit duke analizuar 25 artikuj sipas rregullave të rishikimit të literaturës.



Burimi: Llogaritje të autorëve nga rishikimi i literaturës

Figurë 1. Artikujt sipas periudhës kohore

Figura 1 paraqet vitet e publikimit të botimeve duke i ndarë në dy periudha, artikuj të realizuar para krizës financiare të vitit 2008 dhe artikuj të publikuara pas krizës. Të gjitha studimet shtrihen në kohë dhe bazohen në analizën e të dhënave e panel. Figura 1 tregon qartë që ka pasur një trend në rritje të problemit të kërkimit pas vitit 2008, kjo për shkak të ndikimit të krizës financiare.




Burimi: Llogaritje të autorëve nga rishikimi i literaturës

Figurë 2. Artikujt sipas shtrirjes gjeografike

Figura 2 paraqet shpërndarjen gjeografike të studimeve. Studimet janë kryer në një shtet të caktuar ose në disa shtete, por në figurën 2 artikujt klasifikohen duke u bazuar në kontinentet. Shumica e punës kërkimore janë bërë në Europë (40%), Amerika Veriore (36%) dhe më pas në Azi dhe Afrikë (8%).

Diversifikim i të ardhurave do të thotë shpërndarje optimale të të ardhurave, të hyrave që gjenerohen nga interesi dhe atyre nga veprimtaria bankare si komisionet bankare, fitimet nga tregtimi, këmbimet valutore etj (Gurbuz et al., 2013). Në artikujt e marr në shqyrtim, mënyra e matjes së diversifikimit të të ardhurave është e ngjashme duke u bazuar tek të ardhurat nga jo interesi dhe komponentët e saj. Duke përdorur këtë tregues por edhe të ardhurat nga interesi janë llogaritur indekset HHI dhe DIV.



Burimi: Llogaritje të autorëve nga rishikimi i literaturës

Figurë 3. Variablet më të përdorura për matjen e diversifikimit të të ardhurave

Edhe në figurën 3 shihet që indeksi HHI është mënyra më e përdorur nga autorët për të matur diversifikimin e të ardhurave.

Një teori mund të formulohet për të shpjeguar, parashikuar dhe kuptuar fenomene dhe, në shumë raste, për të zgjeruar njohuritë ekzistuese brenda kufijve të supozimeve kritike. Prandaj le ta konsiderojmë teorinë në një studim si ura lidhëse midis pjesës teorike dhe asaj praktike. Koncepti i diversifikimit të të ardhurave në sektorin bankar mbështet nga teori të ndryshme, por më e përdorura nga autorët është teoria e moderne e portofolit. Teoritë e identifikuar në artikuj, së bashku me frekuenat e tyre paraqiten më poshtë në Tabelën 2. Në kolonën e 3 të tabelës 2, paraqiten edhe arsyet e kryerjes së studimit dhe efekti i diversifikimit.

Tabelë 2. Efekti i diversifikimit të të ardhurave

Nr	Teoria	Arsyeja e kryerjes së studimit	Efekti i diversifikimit	Frekuenca
1	Teoria e kostos së agjencisë	Për çështje që lidhen me menaxhimin e bankave	Diversifikimi i të ardhurave mund të ketë ndikim në praktikën e menaxhimit financiar si: menaxhimi i likuiditetit, buxhetimi i kapitalit, cilësia e aktiveve dhe struktura e kapitalit.	3
2	Teori moderne e portofolit/Teoria e riskut dhe kthimit	Për të evidentuar risqet që përballen bankat	Diversifikimi është një mjet i rëndësishëm për minimizimin e risqeve	16
3	Arbitrage Pricing Theory/Theory of Financial Intermediation	Për të shtuar efikasitetin operacional të bankave	Diversifikimi është mekanizëm për të rritur përfitueshmërinë dhe efikasitetin operacional	2
4	Finance theory	Për të vërtetuar nëse diversifikimi i të ardhurave ndikon në qëndrueshmërinë e bankave	Diversifikimi i të ardhurave ndikon në qëndrueshmërinë e bankave	2

Burimi: Kontributi i autorëve

Ndikimi i diversifikimit të të ardhurave në performancën financiare të bankave

Nga rishikimi të literaturës rezultoi që ekziston mosmarrëveshje midis studiuesve të mëparshëm në lidhje me ndikimin e mundshëm të diversifikimit të të ardhurave në performancën financiare të bankave. Më poshtë në tabelën 3 paraqiten gjetjet kryesore të studimeve, të cilat mund ti përmbledhim në katër pika kryesore:

- Ekzistenca e një marrëdhënie pozitive midis diversifikimit të të ardhurave dhe performacës së bankave;
- Ekzistenca e një marrëdhënie negative midis këtyre variablave;
- Disa nga studime në analizën e tyre treguan që nuk ekziston lidhje midis këtyre variablave;
- Lidhja në formë U midis ndryshoreve përkatëse.

Tabelë 3. Ndikimi i diversifikimit të të ardhurave në performancën e bankave

Nr	Autori/ët	Shteti	Citime	Mostra	Impakti në performancë/risk	Gjetjet kryesore
1	Acharya et al. (2006)	USA	8	105	Asnjë ndikim në performanca ose ne risk	Zhvendosja e bankave tek aktivitetet jo tradicionale nuk dëmton përfitueshmërinë e bankave dhe nuk rrit riskun sistematik
2	Choi & Kotozo (2006)	USA	9	675	Nuk e përcakton efektin	Lloji i diversifikimit mund të ketë ndikime të ndryshme si në performancë ashtu edhe në risk
3	Lee et al. (2014)	USA	10	275	Performanca (-)/Risku (+)	Madhësia dhe diversifikimi i bankës lidhen pozitivisht me një rritje të risqeve, përfshirë rreziqet idiosinkratike dhe sistematike.
4	Olarewaju et al. (2017)	30 vende nën-Sahariane dhe Afrikane	12	250	Performanca (+)	Diversifikimi i veprimtarive operacionale ka një efekt të drejtpërdrejtë dhe të rëndësishëm në performancën financiare të bankave.
5	Delpachitra & Lester (2013)	Australia	13	70	Performanca (-); Tek risku nuk ka ndikim	Të ardhurat nga jo-interesi dhe diversifikimi në aktivitetet bankare ulin performancën, por nuk ndikojnë në riskun e përgjithshëm
6	Osman Gurbuz et al. (2013)	Turqi	20	41	Performanca (+)	Diversifikimi i të ardhurave rrit kthimin e rregulluar ndaj riskut.
7	Yegon & Githaiga (2019)	Kenia	20	31	Performanca (+)	Diversifikimi i të ardhurave ka ndikim në kthimin nga aktivitet
8	Landskroner et al. (2005)	Izrael	35		Performanca (+)	Rritja e të ardhurave nga jo-interesi përmirëson performancën e rregulluar me risk

9	Ngoc Nguyen (2019)	Vietnam	40	29	Performanca (-)/Risku (-)	Rritja e te ardhurave nga jo-interesi ndikon negativisht në performancën e bankave
10	Galvan et al. (2014)	Eurozone	40	845	Performanca (+) Risku (+)	Efekt i pozitiv i diversifikimit është pasojë e përdorimit efikas të burimeve menaxheriale dhe teknike, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në performancë.
11	Ferreira et al. (2019)	Brazil	50	1,019	Performanca (+)	Rritja e të ardhurave nga jo-interesi ndikon pozitivisht në performancën e rregulluar me riskun
12	Lee et al. (2014)	22 European countries	55	2372	Performanca (+) Risku (+)	Diversifikimi i të ardhurave rrit përfitimin dhe rrit riskun
13	Busch & Kick (2009)	Gjermani	77	370	Performanca (+) Risku (+)	Lidhje e fortë midis aktiviteteve të bazuara në interesa dhe performancës financiare
14	Goddard et al. (2008)	USA	120	8910	Performanca (+)	Rritja e aktiviteteve nga jo-interesi ka ndikim pozitiv në performancën e axhustuar me risk.
15	Stiroh (2002)	USA	160	5161	Performanca (-)/Risku (-)	Rritja e aktiviteteve nga jo-interesi për gjenerimin e të ardhurave shoqërohet me rënie të performancës së rregulluar nga risku
16	Chiorazzo et al. (2008)	Itali	196	85	Performanca (+)	Fitimet nga diversifikimi për bankat e mëdha është i kufizuar kurse për bankat e vogla mund të rritet kur të ardhurave nga jo-interesi janë në nivele minimale në fillimin e aktivitetit të tyre.
17	Stiroh & Rumble (2006)	USA	200	1816	Performanca (-)	Rritja e të ardhurave nga jo-interesi ndikon negativisht në performancën e axhustuar me riskun
18	Amidu & Wolfe (2013)	Banka e të vogla në Europë	200	755	Asnjë ndikim në performanca	Rritja e të ardhurave nga jo-interesi ndikon negativisht në performancën e bankave
19	Lepetit et al. (2007)	Disa vende europiane	200	734	Risku (-)	Rritja e të ardhurave nga jo-interesi nga bankat paraqet nivel të lartë të riskut të falimentimit
20	Stiroh et al. (2002)	USA	200	8833	Performanca (+)	Rritja e të ardhurave nga jo-interesi ndikon pozitivisht në performancën financiare të bankave

Burimi: Kontributi i autorëve

Diskutime

Në këtë studim është realizuar rishikimi i literaturës, për të parë sesi autorë të ndryshëm e kanë trajtuar problemin e kërkimit në vende dhe periudha të ndryshme. Në vijësi të punës së autorëve është parashtrimi i problemit dhe mundësitë që ekzistojnë për të kryer një studim të ngjashëm për rastin e Shqipërisë. Fillimisht duhet analizohet situata e sektorit bankar në vend duke kryer hulumtime në lidhje me treguesit që kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me të ardhurat. Këtu mund të përmendim normat e interesit për huanë, diferencën ndërmjet normave të interesit (Hua/Depozita), treguesin e kredive me probleme në nivel banke etj. Pasi është parë niveli i këtyre treguesve dhe krahasimi me normat e percaktuara nga institucionet rregullatore, mund të kalojnë hapin tjetër. Në vijësi është përcaktimi i variablave të studimit (variablat kryesor dhe të kontrollit) dhe mënyra e matjes së tyre. Sugjerohet që treguesi i diversifikimit të të ardhurave të matet me indeksin HHI, kurse performanca financiare duke përdorur raportet Sharpe dhe Z-score. Në lidhje me variablat e kontrollit është e rëndësishme të përcaktohen pasi është kryer analiza e sektorit bankar. Matja e këtyre variablave do të kryhet pasi është krijuar një bazë të dhënash, duke u bazuar në pasqyrat financiare të bankave, të publikuara në faqet zyrtare elektronike. Duke u bazuar në rezultatet e rishikimit sistematik të literaturës, njëri nga katër opsione e mësipërme mund të konsiderohen si rezultat i pritshëm.

Përfundime

Ky punim synoi të analizojë lidhjen midis diversifikimit të të ardhurave dhe performancës financiare të bankave. Faktorët që ndikojnë në të ardhurat e sektorit bankar janë referencë e rëndësishme për menaxherët e bankave por edhe për përdoruesit e tjerë. Menaxhimi efikas i portofolit të huave ka një rol të rëndësishëm në lidhjen midis diversifikimit të të ardhurave dhe performancës së bankave. Studjuesit e mëparshëm kanë dalur në përfundimin që mund të ekzistojnë katër lidhje kryesore midis diversifikimit të të ardhurave dhe performancës bankare duke marrë parasysh faktorë të ndryshëm specifik të bankave dhe ato makro-ekonomikë në periudha të ndryshme kohore. Prandaj është e rëndësishme të kryhet një RSL për të kuptuar marrëdhënien midis variablave. Pjesa më e madhe e studimeve të kryera i përket vendeve europiane dhe atyre amerikane, por ekziston mangësi në kërkim sa i përket vendeve ballkanike kur bën pjesë edhe Shqipëria. Autorët kanë përdorur modele të ndryshme për analizën, si modelet panel të regresionit të shumëfishtë, metoda të përgjithësuara të momenteve. Shumica e studimeve përdorën indeksin HHI për matjen e diversifikimit të të ardhurave ndërsa performanca analizohet duke përdorur kthimin nga aktivet, kthimin nga kapitali, duke e axhustuar me risk. Risku përcaktohet kryesisht nga rezultati Z-score. Rekomandohet që në studimet e ardhshme të përfshihen edhe burimet e tjera të të ardhurave si të ardhurat nga investimet në letrat me vlerë dhe të ardhurat nga zërat jashtë bilancit. Gjithashtu është shumë e rëndësishme që përpara kryerjes së një studimi të tillë, të kryhet një analizë e sistemit bankar, por edhe të rishikohen

artikuj të ngjashëm që mund të jenë kryer në lidhje me problemin e kërkimit. Studimet e analizuara kanë objekt studimi matjen e diversifikimit të të ardhurave dhe të faktorëve të tjerë që ndikojnë në performancën e bankave. Në Shqipëri dhe në rajon, literatura në lidhje me temën mungon. Nuk ka studime të mëparshme apo të përkthyer. Kjo e bën shumë të vështirë krahasimin e rezultateve dhe daljen në përfundime konkrete. Mungesa e këtyre studimeve ka qenë kufizimi kryesor në këtë punim.

7. Referencat

- Acharya, V., Hasan, I., & Saunders, A. (2006). Should banks be diversified? Evidence from individual bank loan portfolios. In *Journal of Business* (Vol. 79, Issue 3, pp. 1355–1412). <https://doi.org/10.1086/500679>
- Agoraki, M., Delis, M., & Pasiouras, F. (2009). Munich Personal Archive Regulations, competition and bank risk-taking in transition countries Regulations, competition and bank risk-taking in transition countries.
- Amidu, M., & Wolfe, S. (2013). Does bank competition and diversification lead to greater stability? Evidence from emerging markets. *Review of Development Finance*, 3(3), 152–166. <https://doi.org/10.1016/j.rdf.2013.08.002>
- Appiah, K. O., Chizema, A., & Arthur, J. (2015). Predicting corporate failure: a systematic literature review of methodological issues. In *International Journal of Law and Management* (Vol. 57, Issue 5, pp. 461–485). Emerald Group Publishing Ltd. <https://doi.org/10.1108/IJLMA-04-2014-0032>
- Bapat, D., & Sagar, M. (2018). Examining Relationship of Income Diversification, Asset Quality with Bank Profitability: Implication for Indian Banks. <https://www.researchgate.net/publication/321300092>
- Busch, Ramona., & Kick, Thomas. (2009). Income diversification in the German banking industry. Dt. Bundesbank.
- Chiorazzo, V., Milani, C., & Salvini, F. (2008). Income diversification and bank performance: Evidence from Italian banks. *Journal of Financial Services Research*, 33(3), 181–203. <https://doi.org/10.1007/s10693-008-0029-4>
- Choi, S., & Kotrozo, J. (2008). Diversification, Bank Risk and Performance: A Cross-Country Comparison.
- De Young, R., Rice, T., Bartholomew, P., Dennis, S., Hanweck, G., Hasan, I., Lemieux, C., Lutton, T., & Wall, L. (2003). Noninterest Income and Financial Performance at U.S. Commercial Banks.
- De Young, R., & Roland, K. P. (2001). Product Mix and Earnings Volatility at Commercial Banks: Evidence from a Degree of Total Leverage Model. *Journal of Financial Intermediation*, 10(1), 54–84. <https://doi.org/10.1006/jfin.2000.0305>
- Delpachitra, S., & Lester, L. (2013). Non-Interest Income: Are Australian Banks Moving Away from their Traditional Businesses? *Economic Papers*, 32(2), 190–199. <https://doi.org/10.1111/1759-3441.12032>

- Ferreira, J. H. L., Zanini, F. A. M., & Alves, T. W. (2019). Bank revenue diversification: Its impact on risk and return in Brazilian banks. *Revista Contabilidade e Finanças*, 30(79), 91–106. <https://doi.org/10.1590/1808-057x201805810>
- Galvan, A., Pindado, J., & de la Torre, C. (2014). Diversification: A Value-Creating or Value-Destroying Strategy? Evidence from the Eurozone Countries. *Journal of Financial Management, Markets and Institutions*, II(1), 43–64. <https://doi.org/10.12831/77236>
- Goddard, J., McKillop, D., & Wilson, J. O. S. (2008). The diversification and financial performance of US credit unions. *Journal of Banking and Finance*, 32(9), 1836–1849. <https://doi.org/10.1016/j.jbankfin.2007.12.015>
- Landskroner, Y., Ruthenberg, D., & Zaken, D. (2005). Diversification and Performance in Banking: The Israeli Case.
- Lee, C. C., Hsieh, M. F., & Yang, S. J. (2014). The relationship between revenue diversification and bank performance: Do financial structures and financial reforms matter?. *Japan and the World Economy*, 29, 18–35. <https://doi.org/10.1016/j.japwor.2013.11.002>
- Lepetit, L., Nys, E., Rous, P., Tarazi, A., Bank, A. T., & Tarazi, A. (2007). Bank income structure and risk: An empirical analysis of European banks. <https://doi.org/10.1016/j.jbankfin.2007.12.002i>
- Ngoc Nguyen. (2019). Revenue Diversification, Risk and Bank Performance of Vietnamese Commercial Banks. *Journal of Risk and Financial Management*, 12(3), 138. <https://doi.org/10.3390/jrfm12030138>
- Olarewaju, O. M., Oseko Migiro, S., & Sibanda, M. (2017). Operational Diversification and Financial Performance of Sub-Saharan Africa Commercial Banks: Static and Dynamic Approach. Credit risk management and economic growth of sub saharan african countries View project Financial Institutions and Services Operational Diversification and Financial Performance of Sub-Saharan Africa Commercial Banks: Static and Dynamic Approach. in *Acta Universitatis Danubius* (Vol. 13). <https://www.researchgate.net/publication/321875167>
- Osman Gürbüz, A., Serhat Yanik, S., & Yusuf Aytürk, Y. (2013). Income Diversification and Bank Performance: E Evidence From Turkish Banking Sector (Issue 1).
- Stiroh, K. J. (2002). Preliminary-Comments Welcome Do Community Banks Benefit from Diversification?
- Stiroh, K. J., Ashcraft, A., Berger, A., Deyoung, B., Flannery, M., Hannan, T., Hughes, J., Lown, C., Morgan, D., Radecki, L., & Strahan, P. (2002). Diversification in Banking Is Noninterest Income the Answer?
- Stiroh, K. J., & Rumble, A. (2006). The dark side of diversification: The case of US financial holding companies. *Journal of Banking and Finance*, 30(8), 2131–2161. <https://doi.org/10.1016/j.jbankfin.2005.04.030>

- Uzhegova, O. (2015). The relative importance of internal factors for bank performance in developed and emerging economies. *Mediterranean Journal of Social Sciences*, 6(3), 277–288. <https://doi.org/10.5901/mjss.2015.v6n3p277>
- Yegon, J. C., & Githaiga, P. N. (2019). Income Diversification and Financial Performance. Should Banks Trade. *Journal of Accounting Finance and Auditing Studies (JAFAS)*, 5(4), 1–14. <https://doi.org/10.32602/jafas.2019.34>